

INSTALIMI I BURIMEVE TË RINOVUESHME TË ENERGJISË

PROCEDURAT E LICENCIMIT DHE
DISA SKENARË PËR KTHIMIN NË
KOHË TË INVESTIMIT (PËR VETËPRODHIKUESIT)

UDHËRRËFYES

| **Tiranë,**
Prill **2023**



HYRJJE

Masat e tranzicionit energjetik në BE lidhen kryesisht me reduktimin e emetimeve të gazeve serë dhe uljen e ndotjes duke nxitur ekonominë përmes teknologjisë së gjelbër, duke krijuar industri dhe transport të qëndrueshëm. Ndërsa në Shqipëri, tranzicioni energjetik nxitet kryesisht nga nevojat për siguri energjetike, pavarësia e furnizimit me rrjet, çmimet konkurruese të energjisë së prodhuar nga burime alternative të energjisë si dielli dhe era, të përmendura përgjithësisht si burime të rinovueshme të energjisë. Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM-të) konsiderohen si aktorë të rëndësishëm për tranzicionin energjetik pasi ato janë pioniere dhe nxitëse për zhvillimin. Në të njëjtën kohë, ato konsiderohen si më të ekspozuarat ndaj rreziqeve të sigurisë së furnizimit dhe rritjes së çmimeve të energjisë dhe prandaj kërkojnë mbështetje specifike. Për t'iu përgjigjur shqetësimeve të tilla të biznesit vendas, Sekretariati i KI, në bashkëpunim me ekspertë të energjisë dhe ekonomisë, përgatiti një analizë mbi mundësitë në dispozicion për NVM-të në Shqipëri duke u fokusuar në: (i) si të përmirësojnë efikasitetin e tyre të energjisë dhe të synojnë potencialin e tyre të kursimit të energjisë; (ii) garantojnë konkurrencën e tyre, nëpërmjet investimeve të zgjuara në burimet e rinovueshme. Ndërkohë që janë bërë shumë përpjekje nga agjencitë qeveritare dhe donatorët për të ofruar informacion për bizneset mbi tranzicionin energjetik dhe masat mbështetëse që lidhen me to, shumë biznese/NVM që operojnë në sektorë të ndryshëm dhe veçanërisht ato që operojnë jashtë qarkut të Tiranës¹, ndeshin vështirësi për t'u njohur me kërkesat ligjore dhe procedurat e licencimit që lidhen me instalimin e burimeve të rinovueshme në mjediset e kompanive të tyre si dhe kohën e kthimit të investimit.

Duke patur parasysh interesin e lartë të bizneseve të shprehur në Mbledhjen e KI nr. 29, por edhe

gjatë fazave të konsultimit për informacion më të thekshtë mbi këto aspekte, Sekretariati përgatiti këtë udhërrëfyes. Dokumenti synon të përmbledhë sa më shumë që të jetë e mundur informacionin përkatës në veçanti për NVM-të e interesuara (prodhuesit me përparësi), në lidhje me dy komponentë kyç: (1) hapat dhe procedurat e licencimit për instalimin e burimeve të rinovueshme; (2) analizë të targetuar në lidhje me kohën e kthimit të investimit duke marrë parasysh specifikat e rajoneve të ndryshme. Udhërrëfyesi mund të ndihmojë gjithashtu NVM-të në analizën e tyre të brendshme ligjore dhe të biznesit përpara se të marrin vendime tregtare për investimin në burimet e rinovueshme. Sipas Ligjit aktual nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", *vetëprodhues i energjisë elektrike, konsiderohet një kompani e vogël ose e mesme, e cila mund të instalojë një kapacitet total deri në 500 kW për prodhimin e energjisë elektrike nga era ose dielli*. Ky kapacitet synon të injektojë energji elektrike të tepërt në rrjetin e shpërndarjes, bazuar në skemën e matjes neto të energjisë elektrike të prodhuar dhe të konsumuar, të llogaritur në baza mujore.

Më shumë informacion mbi këtë studim të përgatitur nga Sekretariati i KI mund të gjendet [këtu](#).

Ai ofron një përditësim mbi licencimin e burimeve alternative - lidhjen e konsumatorëve në tregun e rrjetit të energjisë elektrike me fokus NVM-të, një pasqyrë të shkurtër të tregut të energjisë elektrike (ALPEX) dhe zhvillimet kryesore të tij, një ushtrim krahasues për periudhën e kthimit të investimit nga NVM-të dhe një përshkrim i instrumenteve aktuale financiare dhe partnerëve për programet e zhvillimit në dispozicion të biznesit në fushën e energjisë.

Më shumë informacion mbi rekomandimet e miratuara dhe të adresuara tek institucionet përkatëse mund të gjendet [këtu](#).

1 Sekretariati i KI, [Anketa mbi Enegjinë](#) (janar 2023)

PROCEDURA E LICENCIMIT PËR BURIMET ALTERNATIVE

PREMISA

- » Vetëprodhuesit e energjisë elektrike, bazuar në nenin 37.6.b dhe 49.4, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nuk i nënshtrohen procedurave të licencimit nga Enti Rregullator i Energjisë si dhe rregullave dhe procedurave për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të cilat nuk janë objekt koncesioni.
- » Në nenet 15.1 dhe 15.4, të Ligjit Nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, përcaktohet:
 - Në përputhje me skemën e matjes, një shoqëri e vogël ose e mesme mund të instalojë një kapacitet total deri në 500 kW për prodhimin e energjisë elektrike **nga era ose dielli për të mbuluar një pjesë ose të gjithë energjinë që nevojitet për nevojat e tij dhe të injektojë energjinë e tepërt të prodhuar në rrjetin e shpërndarjes.**
 - Ministri miraton me udhëzim një procedurë të lehtësuar për autorizimin për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të energjisë së rinovueshme.
- » Nga një analizë e bazës ligjore të aplikueshme, rezultojnë që legjislacioni primar, qartësisht e ka klasifikuar prodhimin e energjisë elektrike nga era, si prodhim objekt i skemës neto të matjes së energjisë elektrike (neni 15.1), duke autorizuar ministrin përgjegjës për energjinë për miratimin e procedurës së lehtësuar për autorizimin për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të prodhimit të energjisë elektrike nga era.

LIDHJA E VETËPRODHUESVE ME RRJETIN

- » Vetëprodhuesit lidhen me sistemin elektroenergjitik duke ju nënshtuar procedurave të parashikuara në Udhëzimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 3, datë 20.06.2019 “Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli”. Bazuar në këtë Udhëzim, vetëprodhuesit, për t’u lidhur me sistemin elektroenergjitik, duhet të paraqesin:

A. Lista e dokumentave për aplikim në bashki për impiant fotovoltaik

1. Certifikatë pronësie dhe kartelë e rifreskuar e 3 muajve të fundit (në rast qiramarrije, konsensus i qiradhënësit/pronarit);
2. Planimetri e çatisë, tarracës apo e tokës ku do të vendosen panelet;
3. ID e aplikuesit, ekstrakt i QKB dhe ID e administratorit;
4. Planvendosja e impiantit, projekti dhe foto e gjendjes aktuale e pronës;
5. Projekt elektrik, preventiv dhe grafik punimesh.

B. Lista e dokumentave për aplikim në OSSH për impiant fotovoltaik

1. Plotësimi i formularit të aplikimit “Për skemën e matjes neto”;

2. Deklaratë e konsumit mesatar vjeçar të dy viteve të fundit ose, në rast të mungesës së historikut, raporti i audituesit energjitik si dhe propozimi për fuqinë e instaluar;
 3. Projekti i miratuar për lidhjen e impiantit PV me rrjetin e shpërndarjes;
 4. Propozim mbi modelin e matësit me dy drejtime (skema e matjes neto), të dhëna mbi inverterin kryesor dhe karakteristikat e matësit të vendosur pas tij;
 5. Relacion teknik;
 6. Licenca e inxhinierit projektues;
 7. Leje nga Bashkia "Punime që kryhen me deklaratë paraprake punimesh";
 8. Numri i kontratës ekzistuese pa detyrime të pashlyera.
- » Aplikimi trajtohet brenda 30 ditësh pune nga data e aplikimit. Aplikuesi, në rastin e miratimit, ka afat 6 muaj për të ndërtuar impiantin fotovoltaik. OSSH mund të shkëpusë impiantin nga sistemi energjitik në rast se vërteton që prodhimi tejkalon konsumin e energjisë elektrike në një vit të caktuar kalendarik.
 - » Deri në miratimin e "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së tepricave tek Furnizuesi i Shërbimit Universal, i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik", teprica mujore i kalon Furnizuesit të Shërbimit Universal pa kundërshtpërbllim.

SHËNIM I RËNDËSISHËM

Sipas legjislacionit aktual në fuqi, instalimi i fotovoltaikëve sipas procedurave dhe kapaciteteve të mësipërme nuk i nënshtrohet asnjë takse për ndikimin në infrastrukturë.

Sipas Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" (i ndryshuar), taksa e ndikimit në infrastrukturë zbatohet për ato vepra për të cilat kërkohet leje ndërtimi. Sipas Rregullores për Zhvillimin e Territorit, instalimi i paneleve fotovoltaike klasifikohet si punime për të cilat nuk kërkohet leje ndërtimi, por procedimi i tyre lejohet vetëm në bazë të një deklarimi paraprak të punimeve.

BURIME TË LEGJISLACIONIT TË ZBATUESHËM

- » Ligji Nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"
- » Ligji Nr. 116/2016 "Për Performancën e Energjisë së Ndërtimeve"
- » Ligji Nr. 124/2015 "Për Eficiencën e Energjisë"
- » Ligji Nr. 7/2018, datë 15.2.2018, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike"
- » Ligji Nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike"
- » VKM Nr. 480, datë 31.7.2018, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të energjisë për periudhën 2018-2030"
- » VKM Nr. 369, datë 26.4.2017 "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era"
- » VKM Nr. 27, datë 20.01.2016 "Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Burimet e Energjisë së Rinovueshme 2015-2020"
- » VKM Nr. 619, datë 7.9.2011 "Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për eficiencën e energjisë, 2011-2018"
- » VKM Nr. 38, datë 16.1.2003 "Për miratimin e normave, të rregullave dhe kushteve të projektimit dhe të ndërtimit, të prodhimit dhe ruajtjes së nxehtësisë në ndërtesa"
- » Udhëzim Nr. 3, datë 20.6.2019 "Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli"
- » VKM Nr. 407, datë 19.06.2019 "Për miratimin e procedurës, të kategori ve, kushteve, kërkesave të kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata e audituesit energjetik"
- » VKM Nr. 342, datë 22.5.2019 "Për miratimin e kategorive, të kushteve dhe kërkesave të kualifikimit për menaxherin e energjisë"
- » Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë- <https://www.infrastruktura.gov.al/>
- » Enti Rregullator i Energjisë- <https://www.ere.gov.al/sq/>

ANALIZË MBI KTHIMIN NË KOHË TË INVESTIMIT - SKENARËT

- » Vlerësimi i kthimit të investimit në sektorin energjetik është i rregulluar dhe varion sipas qarqeve. Në tabelën 1 jepet informacion i detajuar për tre qarqe në vend. Është përzgjedhur Tirana për shkak të numrit të lartë të bizneseve dhe si një qark që është në mesataren e nivelit të rrezatimit në vend ndërsa Shkodra dhe Fieri janë përzgjedhur për shkak të dy ekstremeve të rrezatimit diellor, Shkodra me nivelin e rrezatimit më të ulët dhe Fieri me nivelin e rrezatimit më të lartë në vend.
- » Vlerësimet janë bërë për disa fasha të energjisë duke specifikuar edhe nivelin e investimit të nevojshëm. Duke qenë se shumica e bankave e japin kredinë për panelet fotovoltaike deri në 7 vjet, kjo periudhë është marrë për të bërë vlerësimin e kështit të kredisë ndërkohë që si normë interesi është marrë niveli 7 % sipas kushteve të bankave të cilat ofrojnë kredi. Në bazë të këtij informacioni është vlerësuar kështit mujor dhe vlera totale e kredisë e cila mund të krahasohet me vlerën e faturave të energjisë që paguajnë bizneset aktualisht. Në skenarin 2 është dhënë pikërisht informacion mbi pagesën aktuale që bëjnë bizneset sipas fashës përkatëse për energji elektrike si dhe është vlerësuar vlera totale dhe periudha që do iu duhej nëse do merrnin kredi në këto kushte.
- » Nga tabela 1, referuar rastit të qarkut të Tiranës, duket që bizneset që konsumojnë më pak se 2000 kwh/vit janë të disfavorizuar nga investimet në panelet fotovoltaike pasi kështit i kredisë është më i lartë sesa pagesa mujore që bëjnë bizneset. Nga ana tjetër bizneset që janë nga 2000 deri në 5000 kwh/vit janë pothuajse në nivel të barabartë të pagesës së kështit të kredisë me atë të pagesës së faturës së energjisë elektrike dhe për të gjithë bizneset që konsumojnë më shumë se 6000 kwh/vit ka një interes shumë të madh që bizneset të përfshihen në investime për panelet fotovoltaike.
- » E njëjta analizë mund të bëhet edhe për dy qarqet e tjera, si qarqe me të dhëna ekstreme në vend, dhe për gjithë qarqet e tjerë që bien brenda këtyre intervaleve. Informacion më i detajuar për kategoritë e konsumatorëve sipas fashave jepet në tabelën 2.

Tabela 1. Financimi i investimeve në energji, skenarë

TIRANË	Fashat e energjisë (kwh/vit)	Fuqia e instaluar	Investimi	SKENARI 1 - Afat shlyerje për 7 vite			SKENARI 2 - sipas faturës së energjisë		
				Kësti	Pagesa e plotë	Vitet e shlyerjes	Kësti	Pagesa e plotë	Vitet e shlyerjes
	0-1000	8	(1,380,000)	20,828	1,749,543	7 vite	14,000	2,059,583	12 vite e 3 muaj
	2000-5000	41	(6,129,500)	92,511	7,770,889	7 vite	91,300	7,800,873	7 vite e 1 muaj
	6000-15000	122	(14,030,000)	211,750	17,787,025	7 vite	273,900	16,715,643	5 vite e 1 muaj
	20000-40000	325	(23,172,500)	349,735	29,377,751	7 vite	730,400	25,699,102	2 vite e 11 muaj
	50000+	406	(28,947,800)	436,900	36,699,590	7 vite	2,334,000	30,135,943	1 vit e 1 muaj

SHKODËR	Fashat e energjisë (kwh/vit)	Fuqia e instaluar	Investimi	SKENARI 1 - Afat shlyerje për 7 vite			SKENARI 2 - sipas faturës së energjisë		
				Kësti	Pagesa e plotë	Vitet e shlyerjes	Kësti	Pagesa e plotë	Vitet e shlyerjes
	0-1000	9	(1,552,500)	23,431	1,968,236	7 vite	14,000	2,505,519	14 vite e 11 muaj
	2000-5000	45	(6,727,500)	101,536	8,529,024	7 vite	91,300	8,819,001	8 vite e 1 muaj
	6000-15000	134	(15,410,000)	232,578	19,536,569	7 vite	273,900	18,731,995	5 vite e 8 muaj
	20000-40000	358	(25,525,400)	385,247	32,360,722	7 vite	730,400	28,628,654	3 vite e 3 muaj
	50000+	447	(31,871,100)	481,020	40,405,706	7 vite	2,334,000	33,308,929	1 vit e 2 muaj

FIER	Fashat e energjisë (kwh/vit)	Fuqia e instaluar	Investimi	SKENARI 1 - Afat shlyerje për 7 vite			SKENARI 2 - sipas faturës së energjisë		
				Kësti	Pagesa e plotë	Vitet e shlyerjes	Kësti	Pagesa e plotë	Vitet e shlyerjes
	0-1000	9	(1,380,000)	20,828	1,749,543	7 vite	14,000	2,059,583	12 vite e 3 muaj
	2000-5000	38	(5,681,000)	85,742	7,202,287	7 vite	91,300	7,078,399	6 vite e 6 muaj
	6000-15000	113	(12,995,000)	196,129	16,474,868	7 vite	273,900	15,258,090	4 vite e 8 muaj
	20000-40000	303	(21,603,900)	326,061	27,389,103	7 vite	730,400	23,783,360	2 vite e 9 muaj
	50000+	378	(26,951,400)	406,769	27,389,103	7 vite	2,334,000	27,983,354	1 vit

Tabela 2.

Nr	Qarku	Intervali	kwh/vit	kwp	Llogaritja	Konsumatori
1	TIRANË	0-1000	12000	8	12000	konsumator familjar 11.4-50.4
		2000-5000	60000	41	53300	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		6000-15000	180000	122	122000	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		20000-40000	480000	325	201500	konsumator TU, Matje TM - 14.88
		50000+	600000	406	251720	konsumator TM - 22.56
2	DURRËS	0-1000	12000	8	12000	konsumator familjar 11.4-50.4
		2000-5000	60000	41	53300	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		6000-15000	180000	123	123000	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		20000-40000	480000	329	203980	konsumator TU, Matje TM - 14.88
		50000+	600000	412	255440	konsumator TM - 22.56
3	BERAT	0-1000	12000	8	12000	konsumator familjar 11.4-50.4
		2000-5000	60000	42	54600	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		6000-15000	180000	125	125000	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		20000-40000	480000	333	206460	konsumator TU, Matje TM - 14.88
		50000+	600000	417	257920	konsumator TM - 22.56
4	ELBASAN	0-1000	12000	8	12000	konsumator familjar 11.4-50.4
		2000-5000	60000	41	53300	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		6000-15000	180000	122	12200	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		20000-40000	480000	326	202120	konsumator TU, Matje TM - 14.88
		50000+	600000	408	252960	konsumator TM - 22.56
5	KORÇË	0-1000	12000	8	12000	konsumator familjar 11.4-50.4
		2000-5000	60000	40	52000	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		6000-15000	180000	119	119000	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		20000-40000	480000	318	197160	konsumator TU, Matje TM - 14.88
		50000+	600000	397	246140	konsumator TM - 22.56
6	LEZHË	0-1000	12000	8	12000	konsumator familjar 11.4-50.4
		2000-5000	60000	40	52000	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		6000-15000	180000	119	119000	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		20000-40000	480000	318	197160	konsumator TU, Matje TM - 14.88
		50000+	600000	397	246140	konsumator TM - 22.56
7	SHKODËR	0-1000	12000	9	13500	konsumator familjar 11.4-50.4
		2000-5000	60000	45	58500	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		6000-15000	180000	134	134000	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		20000-40000	480000	358	221960	konsumator TU, Matje TM - 14.88
		50000+	600000	447	277140	konsumator TM - 22.56
8	VLORË	0-1000	12000	8	12000	konsumator familjar 11.4-50.4
		2000-5000	60000	41	53300	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		6000-15000	180000	122	122000	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		20000-40000	480000	325	201500	konsumator TU, Matje TM - 14.88
		50000+	600000	406	251720	konsumator TM - 22.56
9	FIER	0-1000	12000	8	12000	konsumator familjar 11.4-50.4
		2000-5000	60000	38	49400	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		6000-15000	180000	113	113000	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		20000-40000	480000	303	187860	konsumator TU, Matje TM - 14.88
		50000+	600000	378	234360	konsumator TM - 22.56

Informacioni i përfshirë në këtë udhëzues nuk është shterues dhe nuk zëvendëson asistencën ose këshillimin profesional që mund t'ju nevojitet ose institucionet përkatëse. Asnjë pjesë e këtyre faqeve, gofite tekst apo imazh, nuk mund të përdoret për ndonjë qëllim tjetër përveç atij të specifikuar.

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Sekretariati teknik i financiar nga BERZH/SECO dhe adreson shqetësimet kryesore të biznesit duke ofruar rekomandime të drejtpërdrejta dhe praktike për Qeverinë dhe partnerët e biznesit për ndërhyrje ligjore dhe institucionale për të përmirësuar klimën e biznesit.

RRETH KËSHILLIT TË INVESTIMEVE NË SHQIPËRI

Këshilli i Investimeve ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikat në vend. Kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke ndihmuar në përmirësimin e institucioneve, ligjeve dhe politikave që promovojnë mirëfunksionimin e tregut.

Dr. Diana Leka (Angoni)

Drejtoresh e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva

Ekspert Ligjor dhe Rregullator
zervae@investment.com.al

Elida Fara

Eksperte Ekonomie
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha


Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula

Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.

 Albania Investment Council  ALInvestCouncil  Albania Investment Council



Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).